


NEWSLETTER E DIASPORËS



PERFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

#121

Grupi Arbëresh "Shega" koncert tek "Reja" në Tiranë



Më 25 gusht 2021, në orën 20:00, Grupi "Shega" do të zhvillojë koncert tek "Reja" në Tiranë. Koncerti organizohet nga Agjencia Kombëtare e Diasporës me mbështetjen e Ministrit të Shtetit për Diasporën, në kuadër të ruajtjes dhe promovimit të kulturës dhe traditave kombëtare. Grupi i të rinjve arbëresh do të prezantojnë për publikun një mbledhje këngësh në gjuhë arbëreshe nga albumi i tyre i parë.

Grupi "Shega" është themeluar nga Giorgio Fusco, Saverio Guzzetta, Rosa Alongi, Giorgio Ciulla dhe Alessandro Ferrantelli nga Hora e Arbëreshëve në Siçili, Itali. Pak ditë më parë, grupi përuroi albumin e tyre të parë me të njëjtin emër. Albumi është një përmbledhje këngësh në gjuhë arbëreshe prej një grupi të rinjsh, të cilët na përcjellin në një udhëtim të mallit të rrënjëve dhe një kulture të jetuar me sy të rinj.



"Apliko online për rinovimim e dokumenteve biometrike"

Shtetasit shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë tashmë kanë mundësi të aplikojnë për rinovimim e dokumentave të tyre biometrike, si dhe të deklarojnë adresën e tyre të vendbanimit online.

Regjistri i mësuesve në Diasporë/ QBD rikujton se aplikimet vazhdojnë deri në fund të shtatorit

QBD rikujton të gjithë mësuesit e gjuhës dhe kulturës shqiptare në Diasporë se aplikimet për Regjistrin e mësuesve në Diasporë do të vazhdojnë deri në fund të shtatorit.

Sipas Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar aplikimet për regjistrin e mësuesve të gjuhës shqipe dhe kulturës në Diasporë, të cilat do të vijojnë deri më 30 shtator 2021.

Pas urdhrat të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve në thirrjen për aplikim janë përcaktuar dhe kriteret për të qenë pjesë e regjistrat të mësuesve jashtë vendit.



Aplikacioni "Dhoma e Biznesit e Diasporës Shqiptare" zëri i biznesit në Diasporë

Gjithçka në "pëllëmbë të dorës" nëpërmjet aplikacionit "Dhoma e Biznesit e Diasporës Shqiptare - ADBC". Informacion të arritshëm për bizneset, sipërmarrësit, anëtarët e Diasporës në Shqipëri, si dhe funksione të ndryshme

Kryetari i KKD Mark Gjonaj vizitë në shkollën e gjuhës shqipe "AlbaLife"



Kryetari i KKD Mark Gjonaj ka zhvilluar një vizitë në shkollën e gjuhës shqipe "AlbaLife në New York.

Z.Mark Gjonaj "Nderi i Kombit" u mirëprit me plot dashamirësi në seminarin e drejtuar nga z.Qemal Zylo themelues dhe drejtues i Shkollave Shqipe si dhe nga të gjithë mësuesit dhe stafi i shkollës.

Gjonaj gjatë vizitës pohoi me krenari se Shkolla Shqipe "Alba Life" është e para që ka vizituar këtë qendër pranë spitalit "Jacobi" e cila do të inagurohet së shpejti dhe ne ndihemi krenar për ju si misionarë për mesimin e Gjuhës Shqipe.



CONNECT ALBANIA

Connect Albania është një program që lehtëson angazhimin e Diasporës Shqiptare që jeton jashtë vendit në zhvillimin e vendit të tyre të lindjes si agjentë zhvillimi për të tërhequr dhe rritur investimet midis komuniteteve shqiptare dhe të huaja përmes mekanizmit online

AKD mbyll gushtin me aktivitete me arbëreshët e Italisë

"Tinguj jete midis tokës dhe detit" është aktiviteti i ndërmarrë nga Agjencia Kombëtare e Diasporës me Komunitetin Arbëresh që do zhvillohet 30-31 gusht dhe 1 shtator.

Aktiviteti do të mbahet në Horën e Arbëreshëve në Siçili dhe në Cerzeto në Kalabri, ku do të zhvillohen takime me përfaqësues të këtij komuniteti dhe ku do të diskutohen çështje me elementët kulturorë, antropologjik, historikë që bashkojnë veçoritë midis Italisë dhe Shqipërisë ndër shekuj.



Është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionet e ndryshme në Diasporë



Diaspora Shqiptare

Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"

SHKARKO APLIKACIONIN FALAS

App store: këtu Play store: këtu



Burgu nuk është vetëm një vend për vuajtjen e dënimit, por mund të jetë edhe letërsi, studim, rritje e njohjeve kulturorë dhe ndërveprim. Nisma "Dhuro libra" do të shërbejë për krijimin e një fondi me libra shqiptarë në institucionet e vuajtjes së dënimit në Greqi dhe Itali.



Digitalizimi i Veprave Shqiptare

Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen